



## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1033\_09\_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 14.10.2013.

### në seancën e mbajtur më datë 24 tetor 2013, nxorri këtë:

## V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I.T. (parashtruesi i ankesës M.T. me shifër të konsumatorit: DPR – 207523) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1033\_09\_13 i datës 26.09.2013.

## Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 21.07.2001 kanë dalur te konsumatori dhe bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 17726746 me gjendje TL=00007 kW (tarifa e lartë) dhe TU=00003 kW (tarifa e ulët). Ky procesverbal i KEK-ut është përpiluar në emër të I.T. Po ashtu Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 21.07.2001 kanë dalur te konsumatori dhe bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 17726748 me gjendje TL=00007 kW (tarifa e lartë) dhe TU=00003 kW (tarifa e ulët). Ky procesverbal i KEK-ut është përpiluar në emër të I.T.

KEK-u me datë 23.06.2003 ka përpiluar një dokument “Shënimet e konsumatorit”, ku janë marrë të gjitha të dhënat e konsumatorit, ku shifra e evidentuar është DPR – 207523, në emër të I.T. numri i njehsorit 17726748.

Konsumatori M.T. (parashtruesi i ankesës) ka parashtruar kërkesë për lidhje të re, ku ka kërkuar regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 45614364, por që punëtorët e autorizuar të KEK-ut në muajin 11/2011 kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik te shifra DPR – 207523, ku është hequr njehsori elektrik nr. 17726748 dhe është vendosur (regjistruar) njehsori elektrik nr. 45614364 me gjendje: TL=444 kW dhe TU=1646 kW. Në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë theksuar se konsumatori njehsori elektrik paraparak nuk e prezanton dhe se pala ka bërë kërkesë për lidhje të re.

Me datë 26.04.2012 punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori nuk është i ngarkuar me kilovatët dhe shihet edhe në listën e leximit ë periodës së parë të vitit 2010, kilovatët janë qitur gabimisht në dy shifra, shifrën



DPR – 270415 që ka qenë e rregull dhe shifrën DPR – 207523 në të cilën janë qitur kilovatët e njëjtë, andaj duhet të korrigojen kilovatët te shifra DPR – 207523 dhe se bashkangjitur është edhe listat e leximit.

Pas kësaj konsumatori me datë 24.12.2012 ka parashtruar ankesë në KEK duke kërkuar shlyerje të borxhit, në arsyetimin se është bërë ngarkim me njehsor tjetër në njehsorin e tij dhe se është edhe i paditur në gjykatë për shkak se është hequr njehsori dhe është vendosur njehsori tjetër. Departamenti për Konsumator në KEK me datë 15.01.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar bazuar në procesin e ndërrimit të njehsorit elektrik, shënimet e konsumatorit, vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik dhe shpenzimit të energjisë elektrike.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 05.02.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.06.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1) KKDFE obligohet që të shkarkoi borxhin e energjisë elektrike në shifrën DPR – 207523 deri në periudhën 12/2011; dhe 2) KKDFE pas marrjes së veprimeve në pikën 1 të këtij vendimi obligohet që shifra DPR - 207523 të kaloj nga emri i I.S.T. në emër MT.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 14.10.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është se me datë 21.07.2001 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë dal në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë pranimin e njehsorit elektrik 17726748 në emër të I.T. po ashtu me datë 23.06.2003 në dokumentin e KEK-ut “shënimet e konsumatorit është përpiluar dokumenti në emër të I.T. Sipas procedurave konsumatori është dashur që të dorëzon njehsorin elektrik por që nuk ka dorëzuar dhe se ka bërë fshehjen e kilovatëve të harxhuar dhe se ndaj konsumatorit është iniciuar kallzim penal. Në vazhdim të ankesës theksohet se sa i përket shifrës DPR – 47316 i cili figuron në emër të S.J. KEDS-i nuk ka kontest dhe se konstatimi i bërë nga punëtorët e KEDS-it është argument i fortë se njehsori është asgjësuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24 tetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 21.07.2001 kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 17726746 ku është nënshkruar konsumatori në këtë procesverbal, si dhe prapë në procesverbalin tjetër kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr. 17726748 por që nuk vërehet nënshkrimi i konsumatorit. Pas kësaj Bordi i ZRRE-së ka vërejtur dhe ka analizuar faturën e Departamentit të Faturimit të KEK-ut të muajit janar 2010 të shifrës DPR – 207523 dhe ka vërejtur se për atë muaj KEK-u e ka faturuar konsumatorin me shpenzim prej 85,489 kWh apo shprehur në vlerë financiare prej 7,294.16€ dhe atë si shpenzim mujor, gjë për të cilën vërehet qartë se nuk është shpenzim mujor i krijuar nga konsumatori. Po ashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin e kontrollës së KEK-ut nr. 1605620 të datës 26.04.2012 dhe ka vërejtur se në këtë procesverbal nga punëtorët e autorizuar të kontrollës është konstatuar se konsumatori është i ngarkuar me kilovat siç shihet edhe në listën e leximit të periodës 01/2010, dhe vërehet se këta kilovatë janë faturuar gabimisht në dy shifra, shifrën DPR – 270415 dhe DPR – 207523, pra në këto dy shifra janë faturuar kilovatët e njëjtë, andaj edhe duhet të korrigojen kilovatët te shifra DPR – 207523.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive të shifrës DPR – 207523 dhe DPR – 270415 dhe ka vërejtur se te shifra DPR – 207523 nga periudha 08/2002 e tutje figuron se ka qenë në funksion njehsori elektrik nr. 17726748 dhe se që nga kjo periudhë e deri më 09/2003 ky njehsor elektrik është faturuar me faturim pa matje/paushall, ndërsa nga periudha 10/2003 e deri më 12/2009 është faturuar me zero shpenzim, ndërsa në muajin



01/2010 në këtë shifër është faturuar shpenzimi prej 85,489 kWh apo shprehur në vlerë financiare prej 7,294.16€. Pas këtij faturimi të bërë nga KEK-u vërehet prapë se nga periudha 02/2010 e deri më 01/2012 kjo shifër është faturuar me shpenzim zero, dhe se pas periudhës së ndërrimit të njehsorit elektrik kjo shifër ka filluar të faturohet me shpenzim të regjistruar në njehsorin elektrik nr. 45614364.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë procesverbalit të kontrollës nr. 1605620 të datës 26.04.2012 dhe listave të leximit të KEK-ut të shifrave DPR – 207523 dhe DPR – 270415 ka vërejtur se në muajin janar 2010 kilovatët e regjistruar në njehsorin elektrik nr. 17726746 janë faturuar gabimisht në dy shifra, shifrën DPR – 270415 dhe DPR – 207523, pra në këto dy shifra janë faturuar kilovatët e njëjtë, pra kilovatët e të dy tarifave (tarifës së lartë dhe të ulët) të shifrës DPR – 270415 të regjistruar deri me atë datë në njehsorin nr. 17726746 i janë bartur apo vendosur gabimisht në shifrën DPR – 207523 në njehsorin elektrik nr. 177267498, dhe kjo duhet konstatuar se është vërtetuar edhe në procesverbalin e kontrollës, andaj edhe duhet të korrigojohen këta kilovat.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe dokumentet e shifrës DPR – 47316 dhe ka vërejtur se në këtë shifër është i regjistruar njehsori elektrik nr. 17726748 në emër të S.J. dhe se sipas dokumenteve të siguruar ky njehsor elektrik te kjo shifër ka ekzistuar që nga periudha 08/2002 dhe përputhet me dokumentin e KKDFE-së për tipin e njehsorit elektrik nr. 17726748 i cili është Iskra T31CDV ku figuron te shifra DPR - 207523 (dokumenti i KEK-ut “Shënimet e konsumatorit”). Andaj pretendimi i KKDFE-së në ankesë se KKDFE nuk ka asnjë kontest me shifrën DPR – 47316 duhet theksuar se edhe ZRRE nuk ka asnjë kontest me këtë shifër, por që gjatë analizave është vërejtur se njehsori elektrik nr. 17726748 i cili është kontestues nga konsumatori ka qenë i regjistruar që nga periudha 08/2002 në këtë shifër, andaj edhe duhet sqaruar se një njehsor elektrik nuk mund të jetë i regjistruar në dy shifra dhe në dy lokacione të ndryshme dhe të regjistrojë energji elektrike në dy shifra.

Sa i përket pretendimit të KKDFE-së që shërbimi juridik ka ushtruar kallëzim penal me datë 27.03.2012 për veprë penale për dëmtim si dhe heqje të instalimeve publike, ZRRE thekson se elementet e veprës penale nuk janë është kompetencë e ZRRE-së për të shqyrtuar dhe se ai kontest ka të bëjë me kontestin e shfrytëzimit të paautorizuar, ndërsa konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK e pastaj edhe në ZRRE për borxhin e ngarkuar në shifrën DPR – 207523 dhe jo për shfrytëzim të paautorizuar, pasi që ai ka kontestuar në tërësi njehsorin elektrik nr. 17726748.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1033\_09\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar